



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 45/12

Prishtinë, më 23.01.2012, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Duda Balje, Sali Asllanaj, Latif Gashi, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Hasime Krasniqi. Muhamet Mustafa dhe Hykmete Bajrami.

Mungoi: Naser Osmani.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Sylejman Shaqiri Drejtor Gjeneral i RTK-së, Rejhane Zylfijaj, Ramadan Islami, nga GIZ, monitorues OSCE, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i ProjekSIONIT të Buxhetit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012 dhe për periudhën janar-mars 2012,**
I ftuar: Rrahman Paçarizi, Kryetar i Bordit të RTK-së;
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i ProjekSIONIT të Buxhetit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012 dhe për periudhën janar-mars 2012

Kryetarja, theksoi se në mbledhjen e fundit kemi kërkuar nga RTK që të plotësojë projeksionet e shpenzimeve më të dhëna më të detalizuara, dhe jemi dakorduar në momentin që të na sjellin do të mbajmë takim më urgjent për të shqyrtuar projeksionet. Në projeksionet e plotësuar janë pasqyruar të hyrat vetanake që planifikon t'i realizojë RTK, dhe në një kolonë tjetër është janë prezantuar shpenzimet ne vitin paraprak, duke mundësuar për të bërë krahasime me shpenzimet e planifikuara në vitin 2012.

Latif Gashi, propozoi që të aprovohet projeksioni i RTK-së siq është propozuar, me qëllim të funksionalizimit të këtij mediumi dhe njëkohësisht propozojë që RTK, të përgatit një material më të detalizuar të buxhetit, ku do të tregohet dhe shifet se ka qenë i shpenzuar buxheti i RTK-së vitin e kaluar dhe sa janë planifikuar këtë vit, të hyrat e planifikuara dhe në këtë mënyrë do të kemi një material më profesional dhe më i specifikuar sipas programeve buxhetore.

Hasime Krasniqi, vlerësoi e shënimet në projeksione janë më të kompletuara se herën e kaluar, por jo ashtu si kërkohet. Zyrtarët që merren me kontabilitet e dinë kërkohet forma të caktuara e raportimit dhe jo si është paraqitur me një tabelë të punuar vetë. Duhet të respektohen ligjet sa i përket mënyrës së raportimit, ku do të pasqyroheshin të hyrat dhe shpenzimet në zëra apo kode buxhetore dhe do të shihej më qartë, psh. se çka ka ndikuar në zvogëlimin e të hyrave vetanake nga marketingu apo të hyrat tjera, cilat janë shkaqe e zvogëlimit të këtyre të hyrave krahasuar me vitin paraprak, dhe në këtë mënyrë mund të shifet më mirë rrjedha e shpenzimeve.

Xhevdet Neziraj, theksoi se përkundër faktit se po ekziston disponimin për të përkrahur projeksionet, kërkesa e komisionit është e qartë, që në të ardhmen projeksionet të paraqiten në mënyrë analitike dhe sintetike, për të pasur një pasqyrë më të detalizuar dhe të specifikuar të të hyrave dhe dalurave buxhetore.

Sali Asllanaj, theksoi se mbështet procedurën më të thjeshtë të raportimit sepse është më e kuptueshme, por natyrisht me të dhëna të mjaftueshme që të shifen planifikimin dhe shpenzimi i mjeteve sipas programeve buxhetore. Më pas pyeti për mjetet e parapara si investime kapitale, për qfarë investime është fjala pasi që më intereson perspektiva e zhvillimit të këtij mediumi publik?

Muhamet Mustafa, vlerësoi projeksionet ridërguar janë më të detalizuara dhe më të specifikuara, që mundësojnë për të kuptuar më mirë destinimin e mjeteve, megjithëse ka pasur mundësi me qenë edhe më të zërthyer. Por nga ajo që po shifet këtë vit RTK ka më pak buxhet se vitin e kaluar, dhe për këtë dëshirojë të dijë cilat mund të jenë pasojat e këtij zvogëlimi, sidomos të programi i investimeve?

Sylejman Shaqiri, në përgjigjen e pyetjeve, njoftoi se në tremujorin e këtij viti kemi buxhet më pak të planifikuar se periudha e njëjtë e viti të kaluar, pasi që që në vitin 2011, në tremujorin e parë në mungesë të buxhetit të Kosovës, e kemi shpenzuar buxhetin sipas ligjit dhe në shumën siq e kemi pasur 2010. Ndërkaq me miratimin e ligjit të buxhetit 2011 na u është shkurtuar buxheti dhe kjo është si pasojë e buxhetit më të vogël. Në ndërkohë kemi hyrë në obligime kontraktuale për të përmbushur obligimet ligjore, ku ndër të tjera thuhet se 20% e programit të jetë nga produksionet e jashtme. Që nga 2009 kemi në rënie prej 30% të të hyrave në buxhetin e RTK-së. Të hyrat nga marketingu janë të kufizuara me ligj. Në rast se ka zgjedhje këtë vit ne presim që të kemi më shumë të hyra nga marketingu. Te pagat dhe mëditjet nuk mund të bëjmë zvogëlime, po ashtu edhe të komunalit si dhe të shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve (si telefonitë, interneti, sateliti, bashkëpunimi me EBU ETJ.) që janë fikse. Ajo çka mund të kursejmë janë investimet kapitale për ta mbyllur vitin buxhetor. Kemi marrur vendim që nuk do të kemi konkurse për vepra audiovizuale as në televizion as në radio për arsye nuk kemi mjete. Këto kursime bëhen për të shlyer borqet. Ndërkaq investimi kapital që është paraparë në projektligjin e ri, për krijimin e kanalit të dytë serb, nuk është planifikuar në mungesë të miratimit të ligjit dhe pasi që kemi të bëjmë

me një projekt me kosto të lartë buxhetore, e që më propozimet aktuale parashihet që 10% e buxhetit të RTK-së të shkojnë direkt për këtë kanal, ndërsa 5% në Zyrën e Kryeministrit për financimin e mediave të komenteve tjera. Raportim financiar do të bëhet sipas ligjit dhe në mënyrë të detalizuar. Poashtu edhe projeksionet do të dorëzohen me kohë dhe më të specifikuar.

Hykmete Bajrami, theksoi se kur kam mësuar diskrapancën e buxhetit të RTK-së në fillim të vitit 2011 dhe duke krahasuar me atë të vitit 2010, e kam pasur shqetësim se si do të kryhen obligimet e krijuara nga RTK. Unë e shoh se nuk është faji i RTK-së që ka hyrë në obligime sepse në tre mujorin e parë të vitit 2011, RTK nuk ka marrur buxhet sa i ka takuar në përmbushjen e aktiviteteve dhe obligimeve ligjore. Mendojë si RTK të duhet të vini me kërkesa të qarta dhe të kërkon diferencën prej 675.000€, se është dashur që kjo shumë të alokohet me rastin e ndarjes së buxhetit për vitin 2011. Do të duhej të Ministria e Financave të pranojë për gabimet në ndarjen më të vogël të buxhetit për RTK për shkak të kufizimeve buxhetore dhe të shlyhen borqe që janë krijuar nga kontraktimet. Ndërkaq nëse RTK ka krijuar obligime më të mëdha se kjo shumë, është obligim i RTK-së që përmes shkurtimeve buxhetore të shlyej borqet. Në këtë drejtim më intereson të dijë a janë obligimet më të mëdha se diferenca prej 675.000€?

Përfaqësuesi financiar i RTK-së, njoftoi se gjysma e obligimeve të RTK-së janë nga periudha e tre mujorit të parë të vitin 2011 por gjysma tjetër janë që nga nëntori 2009, kur është ndalur parapagimi prej KEK-ut.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R EKOMANDIM

1. Komisioni përkrahu projeksionin e të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës, për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2012, në shumën prej 9.960.000 Euro.
2. I rekomandohet Administratës së Kuvendit, të transferojë mjetet buxhetore nga buxheti i Kuvendit – kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në xhirollogarinë e RTK-së nr.1110101219060187, për periudhën 1 janar – 31 mars 2012, në shumën prej 2,065.000 Euro.

Kryetarja, kërkoi nga përfaqësuesit e RTK-së që projeksionet tremujore të të hyrave dhe shpenzimeve të RTK-së ti dërgojnë me kohë dhe në formë të detalizuar, për shqyrtim në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Njëkohësisht edhe raportet periodike dhe vjetore të jenë të përgatitura në mënyrë më të specifikuar dhe detalizuar dhe të dërgohen sipas afateve ligjore në Kuvend.

3. Të ndryshme.

Nuk pati ndonjë çështje për tu diskutuar.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona